




Planuar / Doretuar Puniljena / Prodoto Received / Delivered	05.02.2021	1	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinstva Org / Unit	In Prot In Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHICK	523/2021		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOV

A.Nr. 15/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca, anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A. Nr. 15/2021, të datës 15.01.2021, të parashtruar nga ankuesja të cilën e përfaqëson me autorizim avokat me adresë banimi rruga „Galibardi”, Nr.61, Komuna e Prishtinës, kundër heshtjes administrative të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 05.02.2021, mori këtë

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A. Nr.15/2021 të datës 15.01.2021, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

me datë 15.01.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 151/2021 të regjistruar me numër A.nr.15/2021, kundër heshtjes administrative të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në kërkesën e parashtruar nga ankuesja me nr.prot:1446 të datës 14.10.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 18.01.2021 kërkesën për përgjigje ne ankesës të ankuesit e ka proceduar tek Ministria e Infrastrukturës. Ndërsa Këshilli me datë 18.01.2021, ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 187/2021, se bashku më shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, ka administruar këto prova: Ankesën A nr.15/2021, e datës 15.01.2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 14.10.2020, me numër protokollit 1446, drejtuar Departamentit për

Menaxhimin e Zyrtareve Publik; Autorizimin e datës 18.10.2020, për përfaqësim; Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta të datës 01.06.2018; Marrëveshjen për Shërbime të Veçantat e datës 07.03.2019; Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta te datës 15.07.2019; Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta te datës 09.01.2020; Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta e datës 07.07.2020; dëshmi nga trusti për periudhën 05.10.2017, deri me datë 08.10.2020 ;Letrën e rekomandimit te datës 19.08.2019; Formuarin për Vlerësimin e rezultateve në Punë, për vitin 2019; Certifikatën e datës 08.10.2020; Konkursin e datës 20.03.2018; për Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta; Raportin i Final i Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues; Vendimin e datës 29.03.2018, për Themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Regjistrimi i Aplikacioneve të Pranuar; Renditjen Përfundimtare e Kandidateve; Përmbledhja e Vlerësimeve Individuale; Përcaktimin e Kriteve për Testim me Shkrim dhe me Gojë, për Vendin e Punës për të Cilin nuk Kërkohet Njohja e Ndonjë Gjuhë të Huaj; Vlerësimin Individual të Kandidateve për Vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të huaj; Kërkesën për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Përgjigjen në ankesë e datës 18.01.2021, me numër protokolli 187/2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruar nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar, *sepse*:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill ka deklaruar se fillimisht me datë 14.10.2020 i është drejtuar Departamentin për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë, më kërkesën për deklarimin e statusit të nëpunësit civilë, lidhur me të cilën nuk ka pranuar përgjigje deri në momentin e parashtrimit të ankesës në Këshill. Me tutje, pretendon se ka plotësuar kushtet ligjore për deklarimin e statusit të nëpunësit civil sipas nenit 8 lidhur me nenin 83 paragrafi 2, 3, dhe 4 të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenit 4 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores NR.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, ankueses ti njoh statusin e nëpunësit civil, në pozitën e Asistentes Administrative, në Ministrinë e Infrastrukturës, Njësia e Patentë Shofereve në Ferizaj.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës e parashtruar për shkak të heshtjes administrative, Kolegji ka konstatuar se ankesa e ushtruar në Këshill me datë 15.01.2021 është brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 4 ku përcaktohet se :*Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesja (si ofruer i shërbimeve në cilësinë e Zyrtarit të Logjistikes), ka krijuar marrëdhënie kontraktuale përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta, me Ministrinë e Infrastrukturës (si porositës i shërbimeve), për periudhat kohore: 01.06.2018 – 30.11.2018, 01.12.2018-31.05.2019, 01.06.2019-30.11.2019, 01.12.2019-31.05.2020, 30.06.2020-29.10.2020. Bazuar në formularët e vlerësimit të rezultateve të punës, Kolegji ka gjetur se ankuesja ka treguar rezultate të mira dhe ka përmbushur të gjitha objektivat e punës, për vitin 2018 dhe 2019.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 83 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *Një punonjës aktual, që nuk e ka statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L-149), por që e mbanë një pozitë, e cila është pozitë e Shërbimit Civil për nga funksionet dhe përgjegjësitë sipas nenit 2,*

paragrafit 3 të këtij ligji, do të emërohet si nëpunës civil sipas këtij ligji, nëse i plotëson këto kushte: 2.1. ka qenë në marrëdhënie pune në një institucion të administratës shtetërore apo në një institucion tjetër shtetëror së paku dy vjetët e fundit para hyrjes në fuqi të këtij ligji; 2.2. i plotëson kërkesat e nenit 8 të këtij ligji, dhe 2.3. është vlerësuar për rezultatet në punë në këto dy vjet të paktën "mirë", dhe si rrjedhojë vlerëson se një punonjës aktual i cili nuk e ka statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, por që e mban një pozitë, e cila është pozitë e Shërbimit Civil për nga funksionet dhe përgjegjësitë, mund të emërohet në Shërbimin Civil, nëse punonjësi aktual ka qenë në marrëdhënie pune të themeluar sipas një akti të rregullt juridik respektivisht të ketë krijuar marrëdhënie pune të karakterit juridiko-administrativ, në një institucion të administratës shtetërore apo në një institucion tjetër shtetëror së paku dy vjetët e fundit para hyrjes në fuqi të këtij ligji, si dhe të jenë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me dispozitat e nenit 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku parashihet se: *Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.* 2. Përveç kushteve që parashikohen në paragrafin 1 të këtij neni, kandidatët, për t'u pranuar si nëpunës civilë, nëpunës të Shërbimit Publik dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës, duhet t'i plotësojnë edhe këto kërkesa: 2.1. të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 2.2. të kalojnë me sukses procedurat e pranimit, sipas këtij ligji.

Andaj, duke marr parasysh se ankuesi nuk ka krijuar marrëdhënie pune të natyrës juridike-administrative, por një marrëdhënie kontraktuale me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta për një periudhë të caktuar kohore, ashtu siç parashihej me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit të Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, ku përcaktohej se: *Emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjathtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura "Marrëveshje për shërbime të veçanta" të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit, si dhe duke u bazuar në nenin 84, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil Nr.03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore që t'i njihet statusi i nëpunësit civil, dhe si rrjedhojë pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara.*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike si dhe konstatimit të bazës juridike, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në

të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A. Nr. 15/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Përfaqësuesit Juridik Avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Infrastrukturës;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, në Ministrinë e Punëve të Brendshme
- Arkivit të KPMSHCK-së .

